

## Titulli i Lëndës: AGROPOMOTEKNIKA

Të dhëna bazike të lëndës	
<b>Njësia akademike:</b>	FBV - Departamenti Pemëtari-Vreshtari
<b>Titulli i lëndës:</b>	Agropomoteknika
<b>Niveli:</b>	Master
<b>Statusi lëndës:</b>	Obligative
<b>Viti i studimeve:</b>	Viti i I-rë / Semestri i I-rë
<b>Numri i orëve në javë:</b>	2+1
<b>Vlera në kredi – ECTS:</b>	5 ECTS
<b>Koha / lokacioni:</b>	FBV – Lab 16/ Sipas orarit
<b>Mësimdhënësi i lëndës:</b>	Dr.sc. Vahid Avdiu, Prof.ass.
<b>Detajet kontaktuese:</b>	Zyra nr. 37. tel 038-540-846 E-mail: <a href="mailto:vahid.avdiu@uni-pr.edu">vahid.avdiu@uni-pr.edu</a> ,
<b>Përshkrimi i lëndës</b>	Lënda Agropomoteknika përfshinë: Masat Agroteknike të cilat zbatohen në pemishte siç janë të ushqyerit, ujitja, mirëmbajtja, mbrojtja nga faktorët të pa përshtatshëm të ambientit etj. Masat Pomoteknike që kanë të bëjë me ndërhyrjet direkt në pemë si krasitja, rrallimi i frutave, formësimi dhe arkitektura e kurorave etj.
<b>Qëllimet e lëndës:</b>	Qëllimi i kësaj lënde është njoftimi me masat që duhet ndërmarrë gjatë kultivimit të pemëve. Faktorët biotik dhe abiotik që ndikojnë në kultivimin e pemëve. Kohën dhe mënyrën e aplikimit të masave agroteknike. Arritjen dhe zbatimin e njohurive në formësimin dhe mirëmbajtjen e kurorave të pemëve.
<b>Rezultatet e pritura të nxënies:</b>	Pas përfundimit të këtij kursi (lënde) studenti do të jetë në gjendje që: <ul style="list-style-type: none"> <li>• Të zbatoj plane të avancuara të plehërimit dhe ujitjes së pemëve</li> <li>• Të zbatoj metoda të përshtatshme të mirëmbajtjes së pemishteve</li> <li>• Të aplikoj masa mbrojtëse dhe preventive ndaj faktorëve të pa përshtatshëm biotik dhe abiotik</li> <li>• Të përvetësoj teknikat e krasitjes dimërore dhe asaj të gjelbër</li> <li>• Të aplikoj formësimin e arkitekturave të ndryshme të kurorave të pemëve</li> </ul>

<b>Ngarkesa e studentit (duhet të jetë në përputhje me Rezultatet e Nxënies të studentit)</b>			
<b>Aktiviteti</b>	<b>Orë</b>	<b>Ditë/javë</b>	<b>Gjithësej</b>
Ligjërata	2	15	30
Ushtrime teorike/laboratorike	1	15	15
Punë praktike	5	3	15
Kontaktet me mësimdhënësin/konsultimet	2	4	8
Ushtrime në teren	5	2	10
Kollokfiume,seminare	1	2	2
Detyra të shtëpisë	1	4	4
Koha e studimit vetanë të studentit (në bibliotekë ose në shtëpi)	1	15	15
Përgaditja përfundimtare për provim	3	6	18
Koha e kaluar në vlerësim (teste,kuiz,provim final)	3	2	6
Projektet,prezentimet ,etj	1	2	2
<b>Totali</b>	<b>15</b>	<b>75</b>	<b>125</b>

<b>Metodologjia e mësimdhënies:</b>	Mund të ndryshojë dhe bazohet në punën individuale dhe bashkëpunimi në grup. Metodatat e mësimdhënies që do të përdoren janë ligjëratat, ushtrimet në laborator, puna praktike në fermën didaktike, puna në grupe, seminare, prezantime, demonstrime, vizita studimore etj.
<b>Metodat e vlerësimit:</b>	Studentet duhet të punojnë në ekip, të zhvillojnë mendim kritik, të kenë kreativitet dhe aftësi në prezantimin e njohurive të fituara. Vlerësimi do të bëhet sipas aktivitetit: Vlerësimi i parë intermediar: 35 %, Detyrat e shtëpisë ose angazhime tjera: 15%, Vijimi i rregullt: 10%, Provimi final: 40% Totali 100%
<b>Literatura</b>	
<b>Literatura bazë:</b>	Efendija T, 2005: Pemëtaria e përgjithshme. Prishtine. Thomaj F, 2017: Pemëtaria e përgjithshme, Tiranë Efendia T, 1997: Krasitja e pemëve. Ferraj B, Thomaj T. 2014: Pomologjia 1, Tiranë Ferraj B, 2017: Pomologjia 2, Tiranë Ferraj B, 2017: Atlas i praktikave të modulit “Pomologjia 1”, Tiranë.
<b>Literatura shtesë:</b>	Miljkovic I. 1991: Suvremeno vocarstvo. Nakladni Zavod Znanje. Zagreb. Çakali D., Kullaj E. 2007.: Biologjia e bimëve hortikulturore. Universiteti Bujqësor. Tirane. Shtampar F. et al. 2005: Sadjarstvo. Ljubiana.

Hartimi i planit mësimor:	
Java	Ligjërata që do të zhvillohet
Java 1:	Trendët globale të zhvillimit të pemëtarisë -Prodhimtaria pemëtare format dhe organizimi
Java 2:	Agroteknika e pemëve, farore, bërthamore, arrore, dhe manore
Java 3:	Mënyrat e mbajtje se tokës në pemishte
Java 4:	Plehërimi i pemishteve
Java 5:	Ujitja e pemishteve
Java 6:	Sistemet mbështetëse të pemishteve
Java 7:	Mbrojtja e pemëve nga faktorët natyrorë
Java 8:	Kolokfium
Java 9:	Pomoteknika - Bazat fiziologjike të krasitjes
Java 10:	Teknikat e krasitjes dimërore
Java 11:	Teknikat e krasitjes së gjelbër
Java 12:	Arkitektura e kurorave të pemëve - Format e kurorave standarde
Java 13:	Format e kurorave bashkëkohore “në afërsi të dorës”
Java 14:	Krasitja e pemëve manore (të imëta)
Java 15:	Vlerësimi i dytë intermediar

#### **Politikat akademike dhe Kodi i Sjelljes**

Pjesëmarrja e studenteve e ligjërata dhe ushtrime është e obligueshme. Reflektimi në punë në grupe është i dëshirueshëm. Përdorimi i telefonave në klasë nuk lejohet përveç nëse e kërkon mësimdhënësi. Konsumimi i ushqimit në klasë nuk është i lejuar. Nuk lejohen vonesat në mësim.